



Republika e Kosovës — Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL-Anr.15/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRËSA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, Hidajete Gashi Alaj, dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Rilinda Uka nga Mitrovica, kandidate për asamble të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos decertifikimit nga lista për kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Zgjedhjet Lokale 2025, si kandidate për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, në seancën e panelit të mbajtur me 06.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa Anr.15/2025 e datës 05.09.2025, e parashtruar nga Rilinda Uka nga Mitrovica, kandidate për anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos decertifikimit nga lista për kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 05.09.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rilinda Uka nga Mitrovica, kandidate për asamble të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, e cila ka kërkuar të decertifikohet nga lista e Lëvizjes Vetëvendosje në Mitrovicë për arsye të kalimit të afatit ligjor për decertifikim edhe pse thekson se kërkesën për tërheqje në KQZ e ka bërë më datë 28.08.2025, por që kërkesa nuk është dërguar në KQZ. Tutje ka shtuar se kërkesa për tërheqje vie pasi që është e punësuar në institucion publik pasi që po i kërkohet pezullimi nga puna.

Parashtruesi krahas ankesës ka bashkangjitur si dëshmi listën e vijimit të ditëve në punë, një fotografi me të cilën ka kërkuar tërheqjen nga kandidatura, një fotografi të portalit "KOHA" në të cilën shihen emrat e kandidatëve të decertifikuar, një kopje të emailit dërguar KQZ-së me të cilën ka kërkuar decertifikimin, fotografi të bisedës rreth decertifikimit, email rreth njoftimit të kalimit të afatit për decertifikim.

PZAP-i me datën 05.09.2025 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje në ankesë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 05.09.2025, në të cilën theksohet se pas përfundimit të gjithë procesit të certifikimit të subjekteve politike dhe

kandidatëve të tyre, hapi i radhës është mbajtja e tërheqjes së shortit me çrast të gjitha subjektet politike të certifikuar tërheqin numrat e tyre me të cilët do të radhiten në fletëvotim. Tutje kane shtuar se të gjitha kërkesat për tërheqje të subjekteve politike apo kandidatëve, pranohen dhe trajtohen përderisa arrijnë në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar, deri në dy (2) ditë para datës së caktuar për tërheqje të shortit, sic përcaktohet me nenin 29 të LZP. Kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje janë certifikuar me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me numër 01/2214-2025 të datës 21.08.2025. Në këtë listë është përfshirë edhe kandidatja Rilinda Uka në listën për Asambleenë Komunale në Mitrovicë e Jugut. Zyra ka pranuar një numër të kërkesave për tërheqje nga kandidatët e certifikuar të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje të cilat janë trajtuar dhe Zyra ka rekomanduar KQZ për decertifikimin e këtyre kandidatëve. Siç u theksua më lartë, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 29 të LZP, kërkesat për tërheqje nga procesi zgjedhor bëhen duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje. Kane theksuar se në përputhje me Planin Operacional për Zgjedhjet Lokale 2025, data e caktuar për tërheqjen e shortit është caktuar 4 Shtator 2025. Tërheqjet e kandidatëve janë pranuar deri më 2 Shtator 2025 në ora 11:59. Kandidatja Rilinda Uka ka bërë kërkesë në Zyrë përmes emailit, me datën 3 Shtator 2025 në ora 14:17. Rrjedhimisht, kërkesa e kandidates nuk është pranuar dhe kandidatja është njoftuar që kërkesa në Zyrën është bërë jashtë afatit ligjor për tërheqje të kandidatëve.

Para datës së sipërpërmendur kur ka bërë kërkesë për tërheqje Rilinda Uka, Zyra nuk ka pranuar kërkesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje për largimin e kandidates së tyre nga lista. Në përgjigje kanë bashkëngjitur edhe dëshmitë si email-in, e pranuar nga Rilinda Uka me kërkesë për tërheqje dhe email-in, e kthyer nga Zyra me njoftimin se ka kaluar afati për tërheqje.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas vlerësimit të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidatja për asamble komunale në Komunën e Mitrovicës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) Rilinda Uka, është e pa bazuar.

Paneli ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankesja është e pa bazuar pasi që në nenin 29 par. 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decitive thuhet se : *“Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje, të përcaktuar sipas nenit 25.1 të këtij ligji.”* Në këtë rast KQZ-ja e ka tërhequr shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim me datë 04.09.2025, ndërsa parashtruesja e ankesës, me ankesë nuk ka dorëzuar në PZAP prova materiale se ka dorëzuar deri me datë 02.09.2025, shkresë në KQZ për tërheqje nga lista si kandidate për asamble Komunale në Komunën e Mitrovicës, që rezulton se parashtruesja e ankesës, dhe Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) nuk kanë vepruar bazuar në nenin 29, paragrafit 1 të LZP-së.

Në nenin 117.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decitive thuhet se : *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”*

Në nenin 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decisive thuhet se : *“PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht.”*

Se parashtruesja e ankesës, dhe subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) nuk kanë vepruar bazuar në nenin 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, e konstaton edhe vet parashtruesja e ankesës në ankesën e saj drejtuar në PZAP, ku në ankesën e saj drejtuar në PZAP, ndër të tjera thuhet se *“Unë Rilinda Uka kandidate per asamble nga lista e lëvizjes Vetevendosje ne Mitrovice, per shkak te kalimit te afatit ligjor per decertifikim nga lista...”*.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.A.nr. 15/2025 më datën 06.09.2025.

Kryesues i Panelit
Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.